



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 3.12.2024

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendin e pa plotësuar si më poshtë vijon :

➤ **DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**
SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Zhvillon, teston mirëmban dhe dokumenton programe për kompjuter për proceset e ndryshme të sistemeve të informacionit dhe komunikimit me sisteme të tjera;
2. Ndhmon në kontrollin e sistemeve të informacionit të reja përpara se të zbatohen për të përcaktuar lehtësinë e përdorimit dhe për të gjetur problemet e mundshme;
3. Harton programe për të gjeneruar raporte sipas nevojave të drejtorisë dhe sektorëve të tjerë;
4. Krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të aplikacioneve për të cilat është përgjegjës;
5. Trajnon stafin e suportit të TI në terren, ndihmon procesin e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve për mbledhjen e të dhënave;
6. Identifikon burimin e problemit (software ose gabim anketuesi/ kontrollori) e zgjidh problemin, dhe e diskuton me eprorin;
7. Mirëmban rrjetin kompjuterit të institucionit, kompjutera, printera, fotokopje;
8. Siguron që çdo person është në domain e AZHBR (azhbr.gov.al) dhe është i pajisur me një llogari personale (username dhe fjalëkalim);
9. Ofron support për rrjetin kompjuterik dhe pajiset në rastet kur kanë nevojë në institucion;
10. Merr pjesë në komisione të ndryshme lidhur me IT për të cilat ka nevojë institucioni.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

- Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Kompjuterike. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

1. Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
2. Ligjin nr. 43/2023, datë 29.04.2010, “Për qeverisjen elektronike”;
3. Ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
4. VKM nr. 719/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 6.12.2024, ora 14:00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjolleha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL